

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Sot më datë 12 Prill 2022 (dymije e njezete e dy), lidhet kontrata e shitjes se kuotes ndermjet paleve te mëposhtme:

### SHITESI:

- Shoqeria "MOTUS" Sh.p.k me seli ne adresen Sheshi Italia, Arena Center, Seksioni D, Kati 5, Tirane, person juridik regjistruar me NIPT M02404024C, perfaqesuar sipas Vendimit te Asamblese nr.21, dt.11.04.2022 nga **Z. Idajet ISMAILAJ**, identifikuar me nr. Personal G301220100.

### BLERESI:

- Shoqeria "Ismailaj Group" Sh.p.k, me seli Tirane, Blv.Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati 8, regjistruar prane QKB-se me NIPT M12430005M, perfaqesuar sipas Vendimit te Asamblese date 11.04.2022, nga **Z. Ardit ISMAILAJ**, identifikuar me leternjoftim nr.034606156.

Të sipërpërmendurit, bazuar në nenin 117/1/b të ligjit nr.9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "VIBTIS" SHPK, bien dakord per përpilimin e kësaj "Kontrate për shitje kuote" si më poshtë vijon:

### MEQENESE:

1. Shoqëria "VIBTIS" sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar sipas legjislacionit, regjistruar ne regjistrin tregtar, te mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi të Subjekti (NUIS): L02103503S , me seli ne adresën: Rruga "Dervish Hima", Arena Center, Seksioni B/C, Kati 5, Tiranë (në vijim referuar si "Shoqëria")
2. Bazuar ne ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është 1.000.000,00 (një milion) Lekë i ndarë si vijon:
  - a) Shoqëria "MOTUS" Shpk, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 562,500 (peseqind e gjashtedhete e dy mije e peseqind) Leke, qe perfaqeson 56,25% te kapitalit te Shoqerise;
  - b) Shoqëria "Ismailaj Group" Shpk, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 375,000 (treqind e shtatedhete e pese mije) Leke, qe perfaqeson 37,5% te kapitalit te Shoqerise;
  - c) Znj.Rajmonda Agalliu, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 62,500 (gjashtedhete e dy mije e peseqind) Leke, qe perfaqeson 6,25% te kapitalit te Shoqerise.
3. Shitësi Motus Shpk siç përshkruhet edhe me sipër, është ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 562,500 (peseqind e gjashtedhete e dy mije e peseqind) Leke, qe i korrespondojnë 56,25% (pesedhete e gjashte presje njezete e pese perqind) te kapitalit të saj.
4. Shitësi, dhe njëherazi Ortaku i Shoqërisë, dëshiron të tjetërsojë kuotën qe ai zotëron në Shoqëri, nëpërmjet shitjes tek Blerësi, përkundrejt çmimit të shitjes.



- 
5. Blerësi nga ana tjetër dëshiron të blejë kuotën që Shitësi zotëron tek Shoqëria duke paguar çmimin e shitjes.
  6. Ortaket e shoqërisë "VIBTIS" Shpk me Vendimin e Asamblese së Përgjithshme datë 11.04.2022, bazuar në Ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, kanë vendosur miratimin e shitjes së kuotes prej 56,25% të kapitalit me vlerë nominale 562,500 Leke që Ortaku "Motus" Shpk zotëron në shoqërinë "VIBTIS" shpk në favor të Pales Blerese shoqërisë "Ismailaj Group" sh.p.k.

**PËR KËTË ARSYE**, në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

### **Neni 1** **Objekti i kontratës**

Transferimi me anë të shitblerjes, të 1 (një) kuote që Shitësi zotëron në Shoqërinë "VIBTIS" SHPK, me vlerë nominale 562,500 (peseqind e gjashtedhjetë e dy mijë e peseqind) Leke, që i korrespondojnë 56,25% (peseqind e gjashtë pjesë njezete e pese përqind) të kapitalit të saj.

### **Neni 2** **Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës**

1. Çmimi i shitjes së kuotes që përfaqëson 56,25 % të kapitalit të shoqërisë "VIBTIS" sh.p.k, zotëruar nga ortaku "Motus" Shpk, të cilat transferohen nepermjet kësaj kontrate shitje në favor të shoqërisë "Ismailaj Group" shpk është 562,500 (peseqind e gjashtedhjetë e dy mijë e peseqind) Leke.
2. Blerësi do të paguajë sipas paragrafit të mësipërm çmimin e shitjes në llogarinë bankare të Shitesit konform legjislacionit fiskal në fuqi brenda 15 (peseqind e gjashtë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

### **Neni 3** **Detyrimet e Shitësit**

1. Shitësi garanton se kuota, e cila shitet me këtë kontratë, nuk është e lënë peng, në dorëzani apo e rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i saj e gëzon të drejtat e plota mbi të.
2. Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi kuotën e zotëruar prej tij në këtë shoqëri dhe që po e transferon nepermjet kësaj

---

kontrate shitje ne favor te shoqerise "Ismailaj Group" Shpk, e cila behet pronare e ligjshme e kesaj kuote.

3. Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.
4. Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet/taksat e parashikuara prej legjislacionit Shqiptar në lidhje me transferimin e pronësise se kuotes sipas kësaj kontrate.

#### **Neni 4** **Detyrimet e Blerësit**

1. Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 2 të kësaj kontrate.
2. Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotes që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

#### **Neni 5** **Ligji i Zbatueshem**

- 8.1 Kjo Kontrate hartohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe vlefshmëria dhe realizimi i saj do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 8.2 Për sa nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur në këtë Kontrate, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Shqiptar.

#### **Neni 6** **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 9.1 Nëse midis palëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e mosmarrëveshjes. Pas njoftimit Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 9.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me sa më sipër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 7** **Dispozita Perfundimtare**

Kjo kontratë është përgatitur në Shqip, në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

---

Kjo Kontratë hyn në fuqi ne datën e nënshkrimit te saj nga palët.


Palët pasi lexuan Kontratën bien dakord me sa është përcaktuar më sipër dhe konfirmojnë se ajo është përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar.

**SHITËSI:**

Shoqeria “**MOTUS**”shpk

*Perfaqesuar me Vendim Asambleje nga:*

**Idajet ISMAILAJ**




**BLERËSI:**

Shoqeria “**Ismailaj Group**”shpk

*Perfaqesuar me Vendim Asambleje nga:*

**Ardit ISMAILAJ**



# Njoftim Debitimi / Debit Advice



**Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX**

Dega / Branch 043

Data / Date 12/04/2022

Midas Reference / Midas Reference Number P220412ADYGOP08

Luka Reference / Luka Reference Number 20220412Lubiana.Harapi04341752

Klienti Urdherues / Ordering Customer ISMAILAJ GROUP SHPK M12430005M

Adresa / Address BLV DESHM E KOMB,2 KULLAT K 2 KAT8

Numri i llogarise / Account Number 0001660075

IBAN AL52202110060000000001660075

Shuma e urdheruar 562,500.00

Monedha ALL

Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment KONTRATE SHLYERJE KUOTE

Komisione / Commissions 500.00

Komisione Swift / Swift Commissions 0.0000

Komisione Priority / Priority Commissions 0.0000

Komisione Our / Our Commissions 0.0000

Komisione Total / Total Commissions 500.0000

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer MOTUS SHPK

Adresa / Address TIRANE

TIRANE

ALBANIA

Banka e perfituesit / Beneficiary Bank OTP

Banka Korrespondente / Correspondent Bank ALL01

Numri i llogarise AL68213110440000000001962032

IBAN

Date Valuta / Value Date 12/04/2022

## **Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!**

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.

